

Drejtorio e Regjistrimit  
It



REPUBLIKA SHQIPERISE-  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR  
ELBASAN  
NR 2794/226 aktit

Elbasan me dt 24.05.2010

### SH P A L L J E

Prane kesaj gjykate eshte gjykuar ceshtja civile nr.1069 dt 04.05.2010  
I perket padites Albtelekom Elbasan,paditur "Gledis "SH.P.K.,me objek "Kthim  
Shume".

Sipas kofirmimit rezulton se Firma "Gledis"sh.p.k. ka mbyllur aktizitetin  
e saj,ne qytetin e Lushnjes.

Hartohet kjo shpallje e cila ze vendin e komunikimit per Firmen "Gledis"sh.p.k e cila  
hartohet ne tre kopje ,ku njera qendron ne dosjen gjyqesore,e dyta ne porten e Gjykates  
Elbasan e tjetra ne **QENDREN KOMBETARE TE REGJISTRIMIT,TIRANE.**

**K/SEKRETARI**



**Shaban DEDJA**

**QENDRA KOMBETARE E REGJISTRIMIT**

**TIRANE**

Bashkelidhur,po ju dergojme nje kopje te vendimit  
Nr.1069 dt dt 04/05/2010,e cila` ze vendin e komunikimit per Firma"Gledis" sh.p.k.

**K.SEKRETARI**



**Shaban DEDJA**



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT ELBASAN  
NR.2794 R.TH.CIVIL DATE 8.9.2009  
NR. 1069 I VENDIMIT DATE 4.5.2010

V E N D I M  
NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata e rrethit Elbasan e perbere prej :  
GJYQTARIT TE VETEMILIR PASHAJ,  
Asistuar prej sekretares Diturije Balla, ne Elbasan, me daten 4.5.2010 shqyrtoi ne séance  
pregatitore ceshtjen civile qe i perket padise se

• PADITESIT : Albtelekom sh.a Rajoni Elbasan , perfaqesuar prej Merita Gjorga.

I PADITUR : Firma "Gledis " me seli ne lagje "Skender Libohova" Lushnje, njoftuar  
me afishim prane Qendres Kombetare te Regjistrimit Tirane.

ME OBJEKT : Detyrimin e anes se paditur te kthej shumen e papaguar ndaj paditesit per  
muajt shkurt, mars, prill, te vitit 2008 ne shumen 30362 leke.

BAZA LIGJORE : Nenet 659 ,698,772 te Kodit Civil, Ligji nr. 8618 dt. 14.6.2000 " Per  
telekomunikacionet ne Republiken e Shqiperise"

Ne perfundim te gjykimit ne séance pregatitore te zhvilluar pa pranine e pales paditese  
dhe asaj te paditur, te vilet nuk u paraqiten ne gjykim megjithese te njoftuar;  
Gjykata si shqyrtoi ceshtjen,


V E R E N :

Se ne seancen pregatitore te dates 4.5.2010 nuk u paraqit ne gjykim asnje prej paleve  
ndergjyqese. Rezultoi se paditesi ishte njoftuar per gjykim me leterthirrjen nr. 2794 dt.  
30.3.2010 nepermjet pergjegjeses se administrates Drilona Mema, klundrejt nenshkrimin te saj  
dhe vertetuar nga ftuesi i gjykates, njoftim konform nenit 130 e vijues te K.P.Civile.Kurse i  
padituri ishte njoftuar nepermjet afishimit te njoftimit te njoftimit ne Q.K.R.Tirane, sipas nenit  
141/a te K.P.Civile.

Megjithe marrjen dijene ne leterthirrje , dhe me paralajmerimin se mosparaqitja shkakton  
pushimin e gjykimit, paditesi nuk u paraqit ne gjykim.Gjykata hetoi per mosparaqitjen e  
paditesit por nuk rezultoi ndonje shkak I aresyeshem qe te justifikonte mosparaqitjen e paditesit  
ne gjykim.Paditesi , me asnje lloj menyre nuk kishte vene ne dijene oper ndonje shkak te tille  
justifikues.

Ne seancat e meparshme perfaqesimi i paditesit ishte kryer rregullisht nepermjet  
perfaqesueses se tij, jurists Merita Gjorga.Ne seancen e meparshme te dates 30.3.2010 ishte  
sjelle nga paditesi nje shkrese e tij nr. 163 dt. 9.3.2010 me te cilin njoftonte se perfaqesuesja e tij  
Merita Gjorga nuk ishte me ne marredhenie pune me paditesin,ndaj nuk e perfaqesonte me  
paditesin, kerkonte shtyrjen e gjykimit ,dhe bente me dije se do te merrte masa te menjehershme  
per te siguruar perfaqesimin ne gjykim.

Per kete shkak gjykata ne seancen e dates 30.3.2010 shtyu gjykimin per me daten  
4.5.2010, mese nje muaj me pas , duke i lene paditesit kohe te mjaftueshme per perfaqesim ne  
gjykim.Sa me siper, gjykata i krijoi paditesit mundesine e paraqitjes dhe perfaqesimit ne gjykim,



por mosparaqitja erdhi per faj te paditesit.Ka qene ne detyrimin e paditesit te sigurate perfaqesimin e tij ne gjykim, dhe per gjykaten eshte e mjaftueshme qe i krijoj mundesite per perfaqesim.

Ne keto kushte , gjykata cmon se gjykimi i padise nuk mund te vijoje me tej dhe duhet te pushohet per shkak te mosparaqitjes se paditesit, ne baze te neneve 158/a, 179,299/c te K.P.Civile, pasi mungon pala qe ka disponimin mbi padine, ioniciimin dhe vazhdimin e procesit gjyqesor, pa prezencene te cilit nuk mund te vijoje gjykimi.

PER KETO ARESYE.

Gjykata ne baze te nenit 158/a e 127 te K.P.Civile,

VENDOSI:

1.Pushimin e gjykimit te ceshtjes per shkak mosparaqitjeje te paditesit.

Shpenzimet gjyqesore sic jane kryer prej paditesit.

Kunder vendimit lejohet ankimi ne Gjykaten e Apelit Durres brenda 5 diteve nga e nesermja e shpalljes.Per paditesin dhe te paditurin ky afat fillon nga dita e komunikimit te vendimit.

U shpall publikisht ne Elbasan me daten 4.5.2010.

SEKRETARE

Diturije Balla

GJYQTARI

ILIR PASHAJ

